



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 759/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lulëzim Rrustemi, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Lipjan, paraqitur përshkak të dyshimit të keqpërdorimit të votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

### **V E N D I M**

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e Lulëzim Rrustemi, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega Lipjan.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 07.11.2013, nga Lulëzim Rrustemi, nga subjekti politik PDK dega Lipjan, ne të cilën pretendon se në vendvotimin 1325e në fshatin Banullë dyshon se subjektit politik LDK padrejtësisht i janë shtuar 100 vota që janë në disharmoni me të dhënat që i kanë sjellur vëzhguesit dhe komisionarët e PDK-së me të dhënat e publikuara nga KQZ-ja. Parashtruesi i ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi i të gjithave kutive të votimit në këtë vendvotim.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### **Ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminare i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parashev se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve te vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje


*me këtë ligj*“. Në rastin konkret ankesa është parashtuar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtroi ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim te nenit 118.1 te LZP-së i cili parasheh se “*PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat te cilat nuk i përbushin standarde*” dhe nenit 4.2 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: “*PZAP-i, mund ti hidh poshtë (si te palejuar, të parregullta apo te pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në Nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat te cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore*”, vendosi si ne dispozitiv te ketij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë**

A nr. 759/2013 më datën 08.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi**



**Këshillë juridike:** *PZAP nuk do t'i pranojë kërkeshat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*